Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 14, dhe 17, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", e në mbështetje të nenit 19, paragrafi 3, pika 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019" e konform nenit 22, të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe neneve 15 dhe 28, lidhur me nenin 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datë, 31.08.2026 miraton këtë:

V E N D I M

Neni 1

1.1 znj. Halime SHALA nga fshati Mushtisht Komuna e Suharekës; I jepet në shfrytëzim afatgjatë deri në 99, (nëntëdhjetë e nëntë) vite: **Banesa** e cili gjendet në rrugën "Brigada 123" në Suharekë, hyrja Nr. 2, kati Nr. 2 me sipërfaqe të përgjithshme prej **58.97m²,** sipas certifikatës së pronës **O-72116046-56-2-3-0** me numër të certifikatës **Nr. 501-2026,** të datës **05.08.2026,** zona kadastrale **Suharekë**, vendi i quajtura **"Fshat"** e evidentuar në emër të Komunës së Suharekës, sipas rekomandimit 01-Nr-016-36465 datës 03.08.2026, të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës, për banim familjarë.

1.2 znj. Shkurte TAFAJ nga fshati Greikoc Komuna e Suharekës; I jepet në shfrytëzim afatgjatë deri në 99, (nëntëdhjetë e nëntë) vite: **Banesa** e cili gjendet në rrugën "Brigada 123" në Suharekë, hyrja Nr. 2, kati Nr. 3 me sipërfaqe të përgjithshme prej **58.97m²,** sipas certifikatës së pronës **O-72116046-56-2-7-0** me numër të certifikatës **Nr. 501-2026,** të datës **05.08.2026,** zona kadastrale **Suharekë**, vendi i quajtura **"Fshat"** e evidentuar në emër të Komunës së Suharekës, sipas rekomandimit 01-Nr-016-36465 datës 03.08.2026, të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës, për banim familjarë.

1.3 z. Avdullah KRASNIQI nga fshati Bukosh Komuna e Suharekës; I jepet në shfrytëzim afatgjatë deri në 99, (nëntëdhjetë e nëntë) vite: **Banesa** e cili gjendet në rrugën "Brigada 123" në Suharekë, hyrja Nr. 2, kati Nr. 4 me sipërfaqe të përgjithshme prej **58.97m²,** sipas certifikatës së pronës **O-72116046-56-2-10-0** me numër të certifikatës **Nr. 501-2026,** të datës **05.08.2026,** zona kadastrale **Suharekë**, vendi i quajtura **"Fshat"** e evidentuar në emër të Komunës së Suharekës, sipas rekomandimit 01-Nr-016-36465 datës 03.08.2026, të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës, për banim familjarë.

1.4 znj. Remzije JUPAJ nga fshati Studençan Komuna e Suharekës; I jepet në shfrytëzim afatgjatë deri në 99, (nëntëdhjetë e nëntë) vite: Banesa e cili gjendet në rrugën "Brigada 123" në Suharekë, hyrja Nr. 2, kati NK me sipërfaqe të përgjithshme prej **58.97m²,** sipas certifikatës së pronës **O-72116046-56-2-13-0** me numër të certifikatës **Nr.**

501-2026, të datës **05.08.2026,** zona kadastrale **Suharekë**, vendi i quajtura **"Fshat"** e evidentuar në emër të Komunës së Suharekës, sipas rekomandimit 01-Nr-016-36465 datës 03.08.2026, të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës, për banim familjarë.

Neni 2

Komuna e Suharekës në këtë rast do të përfitoj qira në vlerë perj 1, (një) euro për m² në muja për banesat nga se cili përfitues veç e veç të ceku në neni 1 të këtijë vendimi.

Neni 3

Afati për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme fillon të rrjedh nga data, **31.08.2026,** dhe përfundon afati më datën, **30.08.2125,** pas mbarimit të këtij afati ose ndërprerjes së parakohshme të kontratës e drejta e shfrytëzimit i kthehet Komunës së Suharekës si titullar faktik dhe juridik.

Neni 4

Obligohet Kryetari i Komunës që pas miratimit të vendimit nga Kuvendi i Komunës së Suharekës të nënshkruan kontratë me së cilin veç e veç me me anë të së cilës i përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

Neni 5

5.1 **Obligohen** shfrytëzueset e cekura në pikën **1, 2, 3 dhe 4 të nenit 1,** të këtij vendimi, që pronën e paluajtshme të cekur në pikën 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 1, të këtij vendimi, ta shfrytëzojn me mirëbesim si nikoqire e mirë, që mos t'ia humbë vlerën e saj.

5.2 Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Suharekës dhe si e tillë ajo nuk mund t'i epet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

Neni 6

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurat e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-4611
Më datë 31-08-2026

Kryesuesi i Kuvendit

Mr. ec. Bexhet KUÇI